

Platforma e Punës për Këshillin Drejtues të IEKA

Kandidatura e Egin Koçollarit

Po jetojmë në një periudhë kur të gjitha profesionet po përballen me ndryshime të mëdha teknologjike, rregullatore dhe shoqërore. Roli i IEKA-s në tregun shqiptar mbetet thelbësor për garantimin e cilësisë, integritetit dhe pavarësisë së profesionit të audituesit ligjor në Shqipëri. Kandidatura ime për Këshillin Drejtues të IEKA-s bazohet në bindjen se forca e Institutit qëndron te bashkëpunimi, transparencia dhe zhvillimi i qëndrueshëm, përmes një platforme të hapur dhe gjithëpërfshirëse ndaj anëtarësisë. Qëllimi im është të kontribuoj në: forcimin e rolit të Institutit si partner i besueshëm profesional dhe institucional; promovimin e një kulture dhe një fryme bashkëpunimi midis anëtarëve dhe strukturave drejtuese; zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale përmes trajnimeve, teknologjisë dhe përmirësimit të standardeve; rritjen e ndikimit publik të profesionit të audituesit ligjor si garant i transparencës dhe qeverisjes së mirë në ekonomi.

Besoj se përmes bashkëpunimit, dialogut dhe përkushtimit profesional, IEKA mund të ecë më shpejt drejt një faze të re zhvillimi

— një Institut më modern, më transparent dhe më i lidhur me anëtarët dhe me shoqërinë.

► **1. Përmirësimi i Cilësisë së Auditimit**

► **2. Etika dhe Përgjegjshmëria Profesionale**

► **3. Zhvillimi Profesional dhe Edukimi i Vazhdueshëm**

► **4. Dixhitalizimi dhe Inovacioni në Auditim**

► **5. Pavarësia, Transparenca dhe forcimi i Qeverisjes Institucionale**

► **6. Rritja e Rolit dhe Pranisë së IEKA-s në Treg**